



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

URDHËR

NR. 1192/4 PROT.
DATA 31.07.2015

Nr. 297, Datë 31, 7, 2015.

PËR


SHPALLJEN E ZONAVE TË MBROJTURA TË MONUMENTEVE TË
KULTURËS

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 32 si dhe nenit 7 të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar si dhe të nenit 96 te VKM nr. 671, datë 29.7.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit",

URDHËROJ:

1. Zona e mbrojtur e monumentit të kulturës konsiderohet sipërfaqja e truallit brenda kufirit të pronës në të cilën ndodhet monumenti.
2. Në rast se kufiri i pronës përputhet në njollën e objektit monument kulture, zonë e mbrojtur konsiderohet:
 - a) sipërfaqja e truallit rrëth monumentit, diametri i së cilës përkon me distancën e parashikuar në rregulloren për planifikimin e territorit në fuqi, shumëzuar me koeficentin 1.01, në zonat urbane;
 - b) sipërfaqja e truallit përreth monumentit me gjerësi të vazhduar e jo më e vogël së 100 metra, në zonat rurale.
3. Në raste të veçanta, me kërkesë të palës së interesuar ose institucioneve të specializuara, zona e mbrojtur e monumentit të kulturës përcaktohet me urdhër të veçantë të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
4. Zonat e mbrojtura të shpallura me Urdhër të veçantë të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore ose çdo autoriteti tjetër të parashikuar nga ligji, mbeten në fuqi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



31.07.2015
Mirela KUMBARO FURXHI
X